




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Telkos  
Enver Berisha  
Drejtor  
Prishtinë

### VENDIM

#### **Lidhur me Ankesën nr. 2021/151 Telkos (Palë ankuese) kundër Klan Kosova**

#### Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2020/01, e cila ka hyrë në fuqi më 3 nëntor 2020. Me këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur, shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.
2. KPM me datën 26 shkurt dhe 19 prill 2021 ka pranuar ankesë të parashtruar nga Pala ankuese ndaj OSHAM Klan Kosova, me pretendimin e shkeljes së nenit 10 të Rregullores KPM-2020/01, për shkak të diskriminimit që i është bërë Palës ankuese në raport me operatorin Artmotion dhe IPKO.
3. KPM në lidhje me ankesën e Palës ankuese, atë të datës 26 shkurt 2021 kundër Klan Kosova, lidhur me çështjen e diskriminimit, me datën 2 mars 2021, përmes një shkresë ka kërkuar nga Klan Kosova që t'i ofrojë palës ankuese ofertën ashtu siç ka vepruar me operatorin IPKO.
4. Klan Kosova me datën 10 mars 2021 përmes një përgjigjeje ka sqaruar se është e gatshme të ofrojë mundësinë e transmetimit të kanalit për të gjithë të interesuarit pa asnjë lloj diskriminimi dhe se një ofertë e tillë i është dërguar edhe Palës ankuese, ndërsa ka sqaruar se me operatorin IPKO kanë marrëveshje valide deri në muajin qershor 2021 dhe se të njëjtën janë të obliguar ta respektojnë.
5. KPM bazuar në ankesën e datës 26 shkurt 2021, me datën 16 mars 2021, përmes një shkresë e ka udhëzuar edhe njëherë Klan Kosovën që të na njoftojë për veprimet e ndërmarra për të vepruar në pajtim me nenin 10 paragrafi 2, të Rregullores KPM-2020/01.
6. Klan Kosova me datën 25 mars 2021 përmes një përgjigjeje ka sqaruar edhe njëherë se ka arritur marrëveshje me operatorin Artmotion me të drejta të plota për territorin e Republikës

së Kosovës, të cilën e ka deponuar edhe në KPM, ndërsa ka sqaruar se me operatorin IPKO kanë marrëveshje valide deri në muajin qershor 2021 dhe se të njëjtën janë të obliguar ta respektojnë. Po ashtu, ka sqaruar se me datën 9 nëntor 2020, i është drejtuar Palës ankuese për të arritur marrëveshje të përbashkët për transmetimin e kanalit Klan Kosova duke i dërguar ofertën dhe duke i vënë në dijeni se në rast të mos arritjes së marrëveshjes për të drejtën e transmetimit, atëherë nga data 16 nëntor 2020, duhet të ndërpritet transmetimi i kanalit Klan Kosova nga Pala ankuese.

7. KPM me datën 30 mars 2021, përmes emailit e ka njoftuar Palën ankuese se ka proceduar me ankesën e parashtruar ndaj Klan Kosova, po ashtu e ka njoftuar se Klan Kosova është përgjigjur dhe ka shprehur gatishmëri për të arritur marrëveshje. KPM përmes këtij emali e ka udhëzuar Palën ankuese që të ndërmerr veprimet e ndërsjella për të arritur marrëveshje në mënyrë që kjo çështje të zgjidhet mes palëve.
8. KPM ka gjetur se Artmotion me datën 3 prill 2021, i ka ftuar në takim të përbashkët të gjithë operatorët e shpërndarjes për të diskutuar lidhur me mundësinë e arritjes së marrëveshjes për ritransmetimin e kanaleve që i kanë të drejtat e distribuimit.
9. Artmotion me datën 5 prill 2021, ka konfirmuar takimin e përbashkët me palën ankuese duke ju bërë me dije se është i gatshëm të bashkëpunojë me të gjithë operatorët që janë të licencuar nga KPM-ja. Po ashtu, ka kërkuar nga të gjithë operatorët të cilët nuk kanë marrëveshje me Artmotion për distribuimin e kanaleve të ndërpresin menjëherë ritransmetimin e tyre.
10. KPM ka gjetur se OSHMA Klan Kosova (përmes përfaqësuesit të autorizuar Artmotion) me datën 9 nëntor 2020, i ka dërguar ofertë Palës ankuese, e cila ofertë është deponuar në KPM si dëshmi. Po ashtu, përmes përgjegjës së datës 10 mars 2021 Klan Kosova thekson se Pala ankuese nuk i është përgjigjur ftesës së distribuicionit për arritjen e marrëveshjes për transmetim.
11. KPM, me qëllim të njoftimit më të përafërt me problemet e palëve në arritjen e marrëveshjeve, me datën 11 mars 2021 ka organizuar një takim të përbashkët me përfaqësuesit e operatorëve e shpërndarjes (përfshirë edhe palën ankuese), në mënyrë që të krijohet mundësia e arritjes së një marrëveshjeje në mes të palëve.

### Analiza ligjore

12. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se pretendimet ankimore të Palës Ankuese janë trajtuar në kuptim të nenin 10, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.
13. Neni 10, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2020/01, përcakton se:

*“OSHMA-të të cilat nuk e gëzojnë statusin e bartjes së obligueshme, mund të barten nga operatorët e shpërndarjes vetëm në bazë të marrëveshjes valide.”*

14. KPM ka njoftuar Palën ankuese së OSHMA-të të cilat nuk e gëzojnë statusin e bartjes së obligueshme (ato të cilat janë jashtë brezit-frekuencor radio-difuziv), mund të barten vetëm mbi bazën e një marrëveshjeje valide të arritur me bartësin e të drejtës. Në bazë të këtij neni mbetet obligim i operatorëve të shpërndarjes që të sigurojnë marrëveshje valide për bartjen e një OSHMA-je.
15. Ndërsa neni 10, paragrafi 2, i Rregullores KPM-2020/01, përcakton se:
- “OSHMA-të, pavarësisht formës së transmetimit, duhet të ofrojnë sinjalin në baza jo-diskriminuuese dhe jo-ekskluzive ndaj të gjithë operatorëve të shpërndarjes, në mënyrë që publiku të mos përjashtohet nga qasja në informim”*
16. Në lidhje me pretendimin ankimor se OSHMA Klan Kosova, ka diskriminuar Palën ankuese në raport me operatorin Artmotion, dhe Ipko, KPM ka iniciuar procedurë të vlerësimit dhe ka kërkuar sqarim nga OSHMA Klan Kosova. OSHMA Klan Kosova ka sqaruar se i ka përcjellë ofertë të gjithë operatorëve të shpërndarjes ku me disa prej tyre kanë arritur marrëveshje, duke deponuar edhe marrëveshjen e lidhur me operatorin Artmotion dhe disa operatorë tjerë.
17. KPM konstaton se Palës ankuese i është dërguar oferta dhe dhënë mundësia për të hyrë në marrëveshje ashtu siç përcaktohet me nenin 10 të Rregullores KPM-2020/01. Lidhur me arritjen e marrëveshjeve për transmetim Rregullorja kërkon proces të negocimit në mes të palëve dhe se një marrëveshje transmetimi është çështje e cila duhet arritur në mes të vetë palëve kontraktuese, bazuar në interesat e tyre komerciale, dhe se KPM nuk mund të ndërhyjë në këtë proces.
18. Në bazë të dëshmive të deponuara nga OSHMA Klan Kosova vërehet se Palës ankuese i janë dërguar ofertat për të lidhur marrëveshje transmetimi dhe se nuk është diskriminuar në këtë proces.
19. KPM, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura, konstaton se OSHMA Klan Kosova ka shprehur gatishmëri për të lidhur marrëveshje me palën ankuese, ashtu siç përcaktohet me nenin 10 të Rregullores KPM-2020/01.

#### **Vendim**

20. Refuzohet si e pabazuar Ankesa e Palës ankuese, përmes së cilës pretendohet se OSHMA Klan Kosova ka vepruar në kundërshtim me nenin 10, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores KPM-2020/01.

#### **E drejta për ankesë**

21. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

22. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

  
Xhevat LATIFI  
Kryetar



02.06.2021  
Datë